



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 222 Prot.,

Vlorë, më 08.01. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NËPËRMJET KREDIVE ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA BUXHETI I SHTETIT. MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIN MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET/INDIVIDËT QË PËRFITOJNË NGA KY PROGRAM.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 44, 45, 47, 48, 49, të VKM Nr.453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, të shkresës Nr.15406 Prot., datë 06.12.2024 “Mbi programin për subvencionin e interesave të kredisë”, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë,

V E N D O S I

- I. Të miratojë zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga shteti;
 - Sistemin e pikëzimit për kualifikimin e familjeve/individëve që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur,
 - Nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave të familjeve/individëve, sipas strukturës së apartamentit që përfitojnë, për tu kualifikuar në programin e subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur,
 - Dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet/individët që përfitojnë nga ky program, sipas listës bashkëlidhur.

- II. Efektet financiare sipas pikës 1 dhe 2 do të mbulohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në fondet për programet e strehimit social.

- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike, Enti Kombëtar i Banesave, si edhe institucionet financiare të përzgjedhura nga ministria që financon programin.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha

Me urdhër dhe delegim
N/KRYETARE
Irena Toshkallari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 222 prot

RELACION

01.08.01.2025

Për projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NËPËRMJET KREDIVE ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA BUXHETI I SHTETIT. MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIN MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET/INDIVIDËT QË PËRFITOJNË NGA KY PROGRAM.

Me anë të shkresës Nr. 15406 Prot., datë 06.12.2024 "Mbi programin për subvencionin e interesave të kredisë", Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, njofton njësitë e vetëqeverisjes vendore se në zbatim të VKM Nr.453, datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti" të ndryshuar, ka planifikuar fondet e nevojshme për trajtimin me strehim të familjeve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredive hipotekore me interes 3% në vit, që të aplikojnë sipas ligjit 22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar.

Programi i subvencionimit të interesave të kredive do të targetojë familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- familje të reja dhe të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç,
- gra kryefamiljare/ gra të dhunuara;
- familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,
- familjet me më shumë se katër fëmijë.

Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto grupe. Programi do të vazhdojë të zbatohet nga tre bankat e nivelit të dytë, me të cilat është nënshkruar marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për strehimin që nga viti 2019 (Intesa SanPaolo Bank, Raiffeisen Bank dhe Banka Kombëtare Tregtare). Çdo individ/familje mund ti drejtohet të treja bankave për të marrë ofertën që i përshtatet më mirë kushteve të saj/tij dhe më pas të vijojë me bankën që përzgjedh vetë.

Në këtë shkresë për Bashkinë Vlorë janë përcaktuar si në tabelë:




Tabela mbi numrin e familjeve, që do të trajtohen dhe vlerat maksimale të kredisë

Bashkia	Numri i kuotave	Struktura e apartamentit	Struktura familjare	Sipërfaqet takuese	Vlera maksimale e kredisë
Vlorë	68	Garsonierë	1	45	3,090,600
		Ap.1+1	2	55	3,777,400
		Ap.2+1	3-4	81	5,563,080
		Ap.3+1	5 dhe më shumë	100	6,868,000

Në zbatim të VKM Nr.453, datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti" me shkresën Nr.18627Prot., datë 17.10.2019 "Mbi projektin për subvencionimin e interesave të kredisë" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Vlorë i janë akorduar 140 kuota kredie për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit.

Listat e familjeve të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë janë përcjellë pranë tre bankave të përzgjedhura, Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Intesa Sanpaolo me shkresat e Bashkisë Vlorë Nr.4732Prot., datë 17.06.2020 dhe Nr. 9502Prot., datë 23.08.2022.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Vlorë Nr.4763 Prot., datë 29.03.2024 "Mbi dërgimin e emrave të përfituesëve të kredisë me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit", Enti Kombëtar i Banesave me shkresën Nr.516/1Prot., datë 30.04.2024 "Lista e qytetarëve që kanë përfituar kredi me kushte të lehtësuara nga shteti", ka dërguar emrat e personave që kanë përfituar kredinë, në total lista me 100 përfitues të kredisë. Për rrjedhojë kanë ngelur 40 kuota të kredisë të lira, në pritje të rihapjes së këtij projekti për familjet e pastreha.

Me shkresën Nr.407/53Prot., datë 01.08.2022 "Mbi zgjerimin e programit të subvencionimit të interesave të kredisë për strehim" Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka akorduar edhe 26 kuota shtesë për kredinë me kushte lehtësuese për Bashkinë Vlorë, duke përcaktuar edhe ndryshimet përkatëse në kufirin maksimal të kredisë për familjet sipas strukturave të apartamenteve. Nga kjo kanë ngelur në dispozicion të Bashkisë Vlorë 66 kredi të lira. Bashkë me numrin e kredive të reja të përcaktuara, në total rezultojnë $66+68=134$ kuota në dispozicion të rihapjes së programit të subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit, për shpalljen e njoftimit dhe fillimin e aplikimeve për familjet e pastreha në Bashkinë Vlorë.


Zbatimi i këtij programi do të bëhet në dy faza. Faza e parë, individ/familja do të paraqesë kërkesën përmes portalit unik qeveritar e-albania brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi publik për fillimin e aplikimeve, duke zgjedhur shërbimin "Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social". Faza e dytë, individët/familjet që kanë kaluar fazën e parë, brenda 30 ditëve kalendarike do të depozitojnë pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë Vlorë, formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin e-albania, shoqëruar me dokumentacionin e mbështetur në VKM Nr.384/2019, sipas listës bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Komisioni i strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 07.01.2025 në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi për strehimin social dhe të shkresës Nr.15406 Prot., datë 06.12.2024 “Mbi programin për subvencionin e interesave të kredisë” të ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për caktimin e kuotave të reja të kredisë dhe të masës së rivlerësuar të kredisë që akordohet sipas strukturave familjare dhe të normave të strehimit, po kështu duke konsideruar edhe kuotat e mbartura të kredisë konkludoi se aktualisht Bashkia Vlorë ka në dispozicion 134 kuota kredie për hapjen e programit të subvencionimit të interesave nga buxheti i shtetit.

Sa më lart, komisioni përcaktoi:

1. -Sistemin e pikëzimit për kualifikimin e familjeve/individëve që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë, tabela nr.1 bashkëlidhur
2. -Nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave të familjeve/individëve, sipas strukturës së apartamentit që përfitojnë, për tu kualifikuar në programin e subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti, tabela nr.2 bashkëlidhur
3. -Dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet/individët që përfitojnë nga ky program, kopje të të cilit po vendosim bashkëlidhur këtij projektvendimi, lista bashkëlidhur.

Drejtori i DI&IP
Zambak Selmani



Specialiste e Strehimit
Drita Mustafai



FORMATI I SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROJEKTIN E KREDIVE TË LEHTËSUARA NGA SHTETI

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	Totali 25
I.	Nuk disponon banesë në pronësi	9
II.	Banojnë në banesa rrezik shembje	5
III.	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	3
IV.	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
V	Familjet e dëbuara apo të nxjerra forcërisht nga banesat e palegalizuara, për shkak të investimeve publike	5
1.2	KUSHTET FAMILJARE	Totali 25
I.	Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	6
II.	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore.	2
III.	Familje me më shumë se katër fëmijë	5
IV.	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç	6
V.	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	6
1.3	KUSHTET SOCIALE	Totali 25
I.	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me Vendim të Këshillit të Ministrave	4
II.	Individët me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror deri në 30 vjeç	4
III.	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimt të banesave ish-pronarëve	1
IV.	Emigrantët e rikthyer, punëtorët migrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët, apo personat me mbrojtje plotësuese	2
V.	Familje të policëve të rënë në detyrë	2
VI.	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH, punonjës i repartit RENE, punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri	2
VII.	Viktimat e trafikimit, viktimat e mundshme të trafikimit	4
VIII.	Anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian	3
IX.	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur	1
X.	Individë që i përkasin komunitetit LGBTI	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	Totali 25
A	Familje me të ardhura deri në nivelin maksimal të përcaktuar	25
B	Familje pa të ardhura	0

Shënim: Pikët maksimale që mund të nërfitojë një familje janë 100.

Tabela nr.2

Mbështetur në ligjin 22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social" neni 48, i ndryshuar, ku përcaktohet se, përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët individë a familje me të ardhura vjetore neto baras, ose më të ulëta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg që përfiton individë a familja, dhe në Urdhërin e Ministrit nr.1052, datë 02.12.2024 "Për miratimin e mesatares së çmimeve të tregut sipas zonave kadastrale për njësitë e vetëqeverisjes vendore", ku vlera mesatare për qytetin e Vlorës është 68680 l/m², kemi përcaktuar të ardhurat vjetore neto, mandej të ardhurat maksimale mujore që duhet të ketë familja/individë sipas strukturave të apartamenteve që u takojnë me normat e strehimit, për tu kualifikuar.

Tabela mbi të ardhurat minimale dhe maksimale të përfituesëve të mundshëm

Struktura familjare	Struktura e apartamentit	Niveli i të ardhurave vjetore neto	Niveli maksimal i të ardhurave mujore lek/muaj	Niveli minimal i të ardhurave mujore referuar pagës minimale sipas VKM Nr.113, datë 1.3.2023 lek/muaj
1	garsonierë	515 100	42925	35520
2	1+1	629 567	52 464	35520
3-4	2+1	927 180	77 265	35520
5 dhe me shumë	3+1	1 144 667	95389	35520

Dokumentacioni që duhet të paraqesin aplikantët është si vijon:

I. Për të dhënat personale të aplikantit:

1. Çertifikatë e lindjes së aplikantit
2. Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore

II. Për vërtetimin e kushteve familjare :

1. Çertifikatë familjare
2. Vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijët për çiftet e divorcuara

III. Për vërtetimin e kushteve sociale:

1. Vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara
2. Vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar.
3. Dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë, si rezultat i lirit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara
4. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin emigrant, punëtor emigrant, azilkërkues
5. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e policëve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, etj
6. Urdhër mbrojtje lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje
7. Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane
8. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin
9. Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI
10. Vërtetim me çertifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë

IV. Për vërtetimin e kushteve ekonomike

1. Vërtetim i të ardhurave neto të familjes, me vërtetim nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune
2. Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes
3. Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar
4. Vërtetim nga zyra e punësimit të njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë
5. Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

V. Për vërtetimin e kushteve të strehimit

1. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes dhe nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi të ka humbur për shkak të një fatkeqësie, ose force madhore.
2. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja, apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është nën normat e strehimit në fuqi
3. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që ka ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.
4. Akt-verifikimi nga njësia vendore për
 - banesat rrezik shembje
 - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore
 - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi legalizimit
 - vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës

Akti i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura të cilat klasifikohen si banesë